



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 21.03.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës; 17.03.2022, të parashtruar nga **Expert company sh.p.k, nga Prishtina**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Servisimi i rregullt i xheneratorit 75KW në SHFMU Haradin Bajrami Magure” me Nr. të Prok: 613 022 002 236.

### V E N D I M

**I Refuzohet**, kërkesa për ri-shqyrtim e **Expert company sh.p.k, nga Prishtina** të dt. 17.03.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i rregullt i xheneratorit 75KW në SHFMU Haradin Bajrami Magure”, me nr. të Prok: 613 022 002 236.

**Vërtetohet** Vendimi i AK për Anulim të procedurës, i datës 14.03.2022, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Mbetët në fuqi** Vendimi i AK për anulim të procedurës i publikuar me datë: 14.03.2022.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

**Expert company sh.p.k, nga Prishtina**, me datë; 17.03.2022, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i rregullt i xheneratorit 75KW në SHFMU Haradin Bajrami Magure” me nr. të Prok: 613 022 002 236, ku në këtë aktivitet AK ka anuluar procedurën me date: 14.03.2022, të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

**Edhe pse ju kërkesën për rishqyrtim nuk e keni ngarkuar tek “Kërkesat për rishqyrtim” por tek “Dokumentet tjera” ne prap po ju përgjigjemi.**

**Expert company sh.p.k, nga Prishtina, me datë. 17.03.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i rregullt i xheneratorit 75KW në SHFMU Haradin Bajrami Magure” Autoriteti Kontraktues, me datë 21.03.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:**

*Autoriteti Kontraktues, gjatë vleresimit të ofertes tuaj ka konstatuar që juve ju mungon:*

**Paramasa dhe parallogaria e dorezuar nga ju nuk është plotësuar si duhet, ju mungon çmimi për njesi.**

**Bazuar në Legjislacionin e Prokurimit Publik, në rast se “Mungon çmimi Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm” është Kusht administrativ.**

*Lidhur me pretendimin tuaj që oferta financiare është hartuar jasht çdo standardi, ju në dosjen e tenderit e keni pasur mundësinë për informacione shtesë deri me datë: 03.03.2022, ndërsa ju nuk keni parashtruar asnjë pyetje sqaruese. Në rast që do të kishim ndonjë pyetje në afatin e paraparë në dosje të tenderit, ne do të kishim shqyrtuar atë dhe nëse kish qenë pretendim i bazuar do ta kishim përmirësuar, por në këtë fazë të tenderimit ky pretendim është i pa bazuar.*

**AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.**

**Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thanë më lartë ka vendosur si në dispozitiv.**

**Këshilla juridike:**

**Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**



**Bekim Shabani**

**Drejtor i Prokurimit**